

UDC 343.9.024(497-773)

Iljasa SALIHU, MA

**PASTRIMI I PARAVE TË PISTA DHE FALSIFIKIMI I PARAVE**

**ПЕРЕЊЕ НА ВАЛКАНИТЕ ПАРИ И ФАЛСИФИКУВАЊЕ НА  
ПАРИ**

**LAUNDERING DIRTY MONEY AND COUNTERFEITING IN  
DEVELOPING COUNTRIES**

---

**Abstract**

In this paper titled "Laundering dirty money and counterfeiting in developing countries" is presented a scientifically accepted structure that in itself contains appearance and intercommunication. Initially is elaborated the understanding of money laundering, thus building a suitable floor for the following topics, such as: the legalization of acquired assets in a criminal way, economic and legal impurity in a state - good opportunity for money laundering, challenges of preventing and combating money laundering, counterfeiting of money. This paper consists of necessary titles, perhaps en bloc represents and a sufficient dimensioning of the studying the phenomenon of dirty money laundering and their counterfeiting in developing countries, with special emphasis in Albania, Kosovo and Macedonia.

It should be known that the genesis of dirty money laundering and counterfeiting money in the developing countries flows from those countries from where today we are trying to take them as models of preventing and combating this phenomenon. This crippling economic phenomenon for these countries has a more delayed stationing, but with time and increased various economic demands,

citizens from here, whether they are physics or legal persons, fell prey of Machiavellian doctrines, where this type of economic crime has been cultivated so pressingly, that today has become a real challenge this crime to be combated, even in front of very strong legal mechanisms, economic crime with all its forms has become difficult even to be decreased. Whatever is the situation in institutions and in the field, this paper will be an incentive and awareness, initially social and then scientific, because the preventing and combating of this type of economic crime is possible, it's enough to not be quiet in front of this phenomenon, to consider the cropper factors of the economic crime and lightening the damages that have been caused from the presence of this crime in the states and societies.

### Ligjësimi i pasurive të fituara në rrugë kriminale

Në fjalorin e përditshëm shpeshherë hasim në biseda ku bëhet fjalë për paratë e fituara përmes veprimtarive kriminale, tregtia me drogë, me prostitucion, me cigare, me njerëz e të ngjashme. Për fitimin e atyre parave secili që bën fjalë, pavarësisht kualifikimeve të tyre arsimore, njëzëri do të thonë se ato para janë të ndyta, të pista apo të njollosura, ndaj duhet qëndruar sa më larg atyre parave. Por të njëjtit “kundërshtarë” teorikë shumë shpejt harrojnë se po ato para, tani duke iu nënshtruar procesit të likuiditetit, edhe pse likuiditeti nuk merret me pastrimin e parave, por me shndërrimin e parave në mjete fizike dhe materiale, qarkullojnë nëpër banka, shoqata të ndryshme, bursa etj., por tani të pastruara dhe të përdorshme për veprimtari të ligjshme, mbase edhe të përdorura me dëshirë prej atyre që para pak çastesh flisnin me psherëti për pasojat dhe të këqijat e parave të pista. Ndonëse këta e dinin vetëm atë që në këtë sfond veprimesh ekziston vetëm paraja e pistë, ndërsa për proceset e mëtutjeshme rreth kësaj dukurie shihet se për nga njohuritë janë të kufizuar përmes paaftësisë spontane dhe hermetike. Në këtë grackë të këtij procesi të mjegullt nuk ranë vetëm pjesa e popullit që është

vigjilente për paranë e ndytë, mirëpo aspak e vëmendshme për transformimin e asaj paraje në veprimtari të mëtutjeshme ligjore, por ranë edhe pjesa tjetër që hiqet e arsimuar dhe tejet vigjilente për këtë dukuri shkatërruese, ndonëse i mbylli sytë qëllimisht, sepse dhimbja prej kthetrave të ashpra sociale sikur me çdo kusht, pavarësisht mënyrën e liritimit prej asaj kthetre vrastare, trumbetohet dhe pandehet që të dilet prej këtij ngërçi, për të hapëruar kështu drejt shtigjeve progresive<sup>381</sup>.

Termi pastrim i parave (Money Laundering), në kuptimin që ka sot, për herë të parë është përdorur në SHBA në vitet 70-80 të shekullit të kaluar. Shfaqja e një dukurie të tillë erdhi si pasojë e rritjes së të ardhurave të grupimeve kriminale nga tregtia e paligjshme e lëndëve narkotike dhe e nga riinvestimi i tyre në ekonominë e ligjshme amerikane. Kjo dukuri u emërtua si transformim i parave të pista, të përfituara në rrugë jo të ligjshme, në para të “pastra” që kishin prejardhje “të ligjshme” dhe që mund të hynin lirisht në qarkullimin monetar<sup>382</sup>.

Ligjësimi i mjeteve monetare dhe i pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme ose siç quhet “pastrimi i parave të pista” është një tjetër formë e shfaqjes së veprimtarisë së krimit të organizuar dhe përbërëse e korrupsionit, që parashikohet në legjislacionin tonë penal<sup>383</sup>. Thelbi këtij veprimi kriminal qëndron në synimin, që nëpërmjet veprimtarisë së kundërligjshme t’i krijojnë kushte pronarit të mjeteve monetare apo të pasurive të fituara në rrugë kriminale, që t’i gëzojë ato sikur të ishin përfitime të ligjshme. Kryerësit e kësaj vepre penale mëtojnë që burimin real të të ardhurave ta fshehin për ta krijuar kështu një burim tjetër, gjoja se pasuria prej tani e tutje do të fillojë të shumëzohet. Njëherësh, pastrimi i parave shërben edhe për financimin e grupeve terroriste, mbase në ditët e sotme një veprimtari e tillë kriminale me të madhe është duke u realizuar.

<sup>381</sup> Iljasa Salihu “Krimi ekonomik – sfidat e sigurisë kombëtare në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, përballë krimit ekonomik”, Shkup – 2012, fq. 112

<sup>382</sup> REVISTË SHKENCORE «JUSTINIANI I» Nr.1, dhjetor 2009.

<sup>383</sup> Luan Gjonca, “Korrupsioni”, Tiranë - 2004, f. 193.

Veprimet terroriste këtyre i shërbejnë për tërheqjeje të vëmendjes. Për këtë qëllim përdoren mjete dhe metoda nga më të ndryshmet, ku do të veçojmë taktikat e futjes në qarkullim dhe në riqarkullim të parave që kanë rrjedhur nga veprimtaria kriminale.

Kjo vepër realizohet nëpërmjet këtyre veprimeve<sup>384</sup>:

- Depozitimit, tjetërsimit, transferimit ose këmbimit të parave me qëllim maskimin, fshehjen ose mohimin e përkatësisë apo origjinës së pasurisë, që rrjedh nga veprimtaria kriminale.

- Fitimin e së drejtës së pronësisë mbi çdo lloj pasurie, që rrjedh nga veprimtaria kriminale apo nëpërmjet përdorimit të parave të papastra, natyrisht kur subjekti ka njohuri.

- Ndërmjetësimi në favor të një personi tjetër për depozitimin, tjetërsimin, transferimin dhe këmbimin e mjeteve monetare, me qëllim maskimin, fshehjen ose mohimin e përkatësisë ose të origjinës që rrjedh nga veprimtaria kriminale...

Ligjësimi i parave të papastra rëndom bëhet përmes rrugës institucionale, duke gravituar kështu edhe persona me autoritet të politikës së vendit. Vende të preferuara për pastrim të parave janë shtetet me politikë jostabile dhe me ekonomi të pazhvilluar, ku ata që dëshirojnë të investojnë në kësi lloj shtetesh, shpeshherë qëllimisht harrohen të pyeten për burimin e atyre mjeteve që synohen të investohen nëpër veprimtari tregtare apo prodhuese në vendin përkatës. Përmes procedurave burokratike dhe gjuhës së parave e cila lehtësisht i bind mendjet e ndryshkëta, bëhet i mundur pa ndonjë problem të theksuar jetësimi i fazës së pastrimit të parave<sup>385</sup>.

Kështu, fjala bie, vendet e Ballkanit Perëndimor janë vende tejet të përshtatshme për shpëlarje parash, duke mos i mënjeluar edhe vendet e tjera, që gjenden në “hallin” e njëjtë të këtyre vendeve, me përjashtim të ndonjë metode dhe mënyre shtesë apo të mangët. Siç është e njohur dhe shpesh herë e përsëritur se pastrimi i parave

<sup>384</sup> Po aty, f. 194.

<sup>385</sup> Iljasa Salihu “Krimi ekonomik – sfidat e sigurisë kombëtare në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, përballë krimit ekonomik”, Shkup – 2012, f. 113.

ka të bëjë me përfitimin e pasurisë nga aktivitetet ilegale dhe përpjekjet që këto përfitime të vendosen në sistemet bankare, në mënyrë që të fshihet origjina e tyre. Kështu po e marrim shembull Kosovën, si një vend më i përshtatshëm për veprimtari të tilla, edhe pse Shqipëria dhe Maqedonia aspak nuk janë imune ndaj një gjëme të tillë. Në Maqedoni në sajë të deklaratave të opozitës maqedonase thuhet se qeveria me anë të projektit “Shkupi 2014” ka bërë pastrim parash<sup>386</sup>. Kështu që, profesori Muhamed Sadiku nga Kosova, thotë se: *“krimi financiar në Kosovë është i pranishëm dhe terreni për shtrirjen e këtij aktiviteti është mjaft i përshtatshëm. Format më të shpeshta të krimit financiar janë evazioni fiskal, përfitimet nga kontrabandimi i mallrave dhe përvetësimi i fondeve publike. Si shoqëruet i të gjitha këtyre fenomeneve, unë vlerësoj se edhe në Kosovë ka ardhur fenomeni i shpëlarjes së parave, që nganjëherë quhet trafikimi financiar”*<sup>387</sup>.

Se kjo dukuri është e pranishme në Kosovë, pohojnë edhe zyrtarë në Policinë e Kosovës. Sabrije Kamberi, zëdhënëse në këtë institucion, thekson: *“dukuria e pastrimit të parave është e shprehur, por jo në numër shumë të madh. Policia e Kosovës në raste të tilla pranon informacione nga burime të ndryshme dhe çdo informatë trajtohet në mënyrë të plotë dhe profesionale dhe nëse gjenden dyshime, fillohen hetime në konsultim me Prokurorinë. Rastet e pastrimit të parave janë raste komplekse dhe si të tilla mund të fillojnë nën dyshimin se janë raste të pastrimit të parave. Por më vonë dalin se janë raste të përfitimit joproporcional ose shmangie nga tatimi”*<sup>388</sup>.

Duke e marrë në përgjithësi, përpos mekanizmave të tjerë juridikë që duhet ndërmarrë një shtet, që sa më lehtë të mund ta përballojë këtë dukuri kundërligjore dhe kundërnjerëzore, mes të

<sup>386</sup> Për më tepër shih këtu: [http://time.ikub.al/9c08348a1f/6e470a8f9d9c97bca722be2c33311970/Lajm\\_Shkupi-2014-projekt-per-larje-parash-i-cili-ndan-Maqedonine-ne-baza-etnike-dhe-religjioze.aspx](http://time.ikub.al/9c08348a1f/6e470a8f9d9c97bca722be2c33311970/Lajm_Shkupi-2014-projekt-per-larje-parash-i-cili-ndan-Maqedonine-ne-baza-etnike-dhe-religjioze.aspx)

<sup>387</sup> Për më tepër shih portalin: [www.evropaelire.org/content/article/2083353.html](http://www.evropaelire.org/content/article/2083353.html)

<sup>388</sup> Po aty.

tjerash është e nevojshme që nga procesi i privatizimit të kërkohen në hollësi të gjitha dokumentet, raportet, kontratat dhe rezultatet e revizionit, kuptohet nëse është bërë, nëse jo, atëherë të gërmohet çështja e këtij “kapërcimi të verbër”. Pastaj mekanizmat shtetërorë, duke mos bërë asnjë lloj kompromisi mbi subjektin juridik apo fizik investues, që fillimisht ta dokumentojë dhe argumentojë burimin e të ardhurave, duke kontaktuar pastaj edhe zyrtarisht me atë “*krua furnizues*”. Nëse këto inspektive, që në dukje shihen si tepër modeste, nuk kryhen, atëherë çdo hap i mëtutjeshëm, nuk është gjë tjetër, pos konfirmim i pozicionit zyrtar, që procesin e legalizimit të parave të pista, ta kryejë nëpërmjet institucioneve legale, mbase edhe konfirmim i asaj se institucioni legal, por në thelb i fëlliqur deri në fyt po bën ligjësimin e parave të fëlliqura deri në kupë të kokës.

### Papastërtia ekonomike dhe juridike në një shtet, mundësi për larje të parave

Duke marrë parasysh vështirësitë që lindën në të kaluarën e largët, me rastin e realizimit të transaksioneve të ndërlikuara, lindi nevoja për një ndërmjetësues, i cili do të tregonte vlerën e vërtetë dhe momentale të mallrave, ngase përmes këmbimit të thjeshtë, i njohur si këmbimi i mallit me mall, ishte shumë vështirë të realizohet një tregti në përmasa përafërsisht të barabarta ndërmjet shitblerësve. Kësisoj, nevoja e këtij kursi të atëhershëm tregtar, lindi parane. Mbase, sikurse çdo lindje dhe zbulim tjetër, që shoqërohet menjëherë me të kundërtën apo me armikun e saj, edhe paraja si dukuri shoqërore e ekonomike nuk shpëtoi dot nga një shoqërim i tillë.

Armiqtë apo veprat penale të parasë janë të shumta, ndaj në pamundësi kohore dha hapësinore për paraqitjen e të gjithëve, diskursin e studimit tonë do ta orientojmë në dukurinë e pastrimit të parave të pista . Pastrimi apo larja e parave është kthimi i të ardhurave të realizuara ndër vite apo muaj, me mjete jashtëligjore në pasuri, të cilave është vështirë t’u gjendet origjina apo burimi i

grumbullimit të të ardhurave. Shtetet e preferuara dhe të përshtatshme për larje të parave janë ato shtete të cilat janë të zhytura në pislleqe juridike, ekonomike, politike dhe shoqërore. Është pak paradoksale që paratë e pista të pastrohen në një vend me nivel të lartë të pisllekut, por edhe më e pakuptueshme është ajo, që trumbetohet prej autoriteteve të rendit dhe të sigurisë, gjoja se agjenci për pengimin e larjeve të parave, detyrën e tyre janë duke e kryer me sukses, mbase populli dhe qytetari që gjithherë di të jetë barometri më i arsyeshëm dhe i saktë për gjithçka, atë sukses të proklamuar prej baltës së thatë, të paktën një herë në jetë ende nuk arritën ta shohin<sup>389</sup>.

Paratë e fituara në këtë mënyrë, janë para të shoqërisë, para këto që nesër shoqëria do t'i sheh ligjërisht si të tjetërkujt. Kësodore, paralelisht me larjen e parave të pista lahen edhe njerëzit e ndytë në një vend po ashtu të ndytë, ngase amnistia nga një vepër penale e tillë bëhet prej fundërrinave të cilët qeverisin me pushtetin.

Janë të njohura rastet nga jeta e përditshme, kur një afarist me veprimtarinë e tij kundërligjore dhe kundërnjerëzore bën grumbullimin e pasurisë në vend apo jashtë vendit, investon në ndonjë ndërmarrje apo në ndonjë objekt kombëtar dhe fetar, pastaj si nga pushteti ashtu edhe nga populli, njeriu në fjalë njihet si njeri i ndershëm, bamirës apo i devotshëm, kurse në të vërtetë ky njeri kriminel është në fazën evolucionare të pastrimit. Shumë shtete me ekonomi të zhvilluar dhe me sistem të shëndoshë juridik prej kohësh janë duke grumbulluar para vetës masa për parandalimin e kësaj dukurie rrënues. Shtetet me sisteme të mirëfillta në aspektin e përgjithshëm e preferojnë më shumë parandalimin sesa luftimin. Ndërkaq, fjala bie, shteti i Maqedonisë, që deri në fyt është i zhytur dhe i përfshirë prej një sëmundje të këthillë, mekanizmat shtetërorë të dobëta të përgjithshme e preferojnë më shumë luftimin sesa parandalimin e larjes së parave (në teori paraqiten për parandalimin, kurse në jetën reale e manifestojnë luftimin gjysmak dhe sipërfaqësor).

<sup>389</sup> Iljasa Salihu "Krimi ekonomik – sfidat e sigurisë kombëtare në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, përballë krimit ekonomik", Shkup – 2012, f. 116.

Këta më shumë e preferojnë që të sëmurin ta shërojnë sesa të shëndoshin ta ruajnë që të mos sëmuret<sup>390</sup>.

Pse ky shtet e pëlqen më shumë luftimin, sesa parandalimin e kësaj dukurie shkatërruese. Sepse përmes luftimit bumi nëpër medime (në vend të mejdanit burrëror), besueshmëria dhe ngritja e “admirimit” partiak do të jenë në qendër të vëmendjes, kurse përmes parandalimit shteti duhet ta ulë papunësinë, të ofrojë shërbime administrative të shpejta dhe efikase, të ndajë mjete buxhetore për trajnime të qytetarëve rreth të kuptuarit të dukurisë së larjeve të parave, t’i kërkojë burimin financiar të gjithë bankave dhe firmave, t’i dënojë ashpër punëdhënësit që asnjë kontribut juridik nuk ua realizojnë punëtorëve, si dhe përmes parandalimit urgjentisht pushtetarët duhen të flijohen nga të jetuarit super luksoz. Të gjithë këto masa parandaluese për qytetarin e thjeshtë nuk janë të vërejtura edhe aq shumë (edhe pse shumë të dobishme për ta), kurse arrestimi i një biznesmeni malazez si i dyshuar për larje të parave, përmes firmës së tij në Shkup, i cili ka larë rreth 30 milion dollarë të lëshuara kryesisht nga firmat e huaja, u vërejt goxha shumë. Në kësi lloj mënyrash shteti ynë përballet me larjen e parave të pista, në cilësinë e luftimit e assesit të parandalimit. Ky rast i rrallë në Maqedoni u vlerësua si një e arritur e madhe e drejtorisë për pengim të larjes së parave. Rasti në fjalë njëkohësisht ishte edhe një dalje nga anonimiteti i kësaj drejtorie, ngase ne si qytetarë edhe pse çdo ditë shihnim dhe shohim se si njerëzit pasurohen dhe ndërtojnë objekte që as vetë nuk e dinë burimin e të ardhurave dhe në të njëjtën kohë drejtorisë në fjalë nuk ia kishim dëgjuar asnjë fjalë. Me të drejtë konstaton profesori Hamit Aliu, kur thotë: *“angazhimi i agjencive për larjen e parave në aspektin financiar është vetëm formal, kemi drejtorinë për këtë çështje, por realisht në praktikë ata s’kanë aftësi dhe kapacitet për ta ndjekur këtë proces”*<sup>391</sup>.

Larje të parave në këtë shtet kemi kudo. Mjafton që të kthemi me mendje para katër vjetëve. Ta kujtojmë gjendjen sociale dhe

<sup>390</sup> Po aty.

<sup>391</sup> Për më tepër shih portalin: <http://lajmpress.com/lajme/maqedoni/1084.html>



financiare të ministrave apo të deputetëve, si dhe një dallim prej gjendjes së atëhershme në këtë të sotme dhe do të mbesim pa fjalë dhe pa pasthirrma kur do t'ua shohim shtëpitë, banesat, veturat dhe bizneset e tjera, të cilët mbijnë sikur kërpudhat pas shiut. A nuk janë këto dhe shumë veprimtari të tjera larje të parave, që ndershmërisht iu morën qytetarëve, për t'u keqpërdorur prej njerëzve me autoritet të lartë në shtet, mbase këta paratë i morën prej qytetarëve të pastra, kurse përmes gjarpërimit të rrugës, këta i ndotën ato para, si dhe faza në fazën e fundit, përmes investimeve të "ligjshme" në objekte kapitale dhe jokapitale, ata e bënë fazën e fundit që përkon me "mbylljen" e procesit të këtij krimi, pra duke i pastruar paratë prej atij burimi dhe asaj rruge të fëlliqur. Kjo nuk është vetëm larje e parave të mjeteve monetare të qytetarëve, por është larja e trurit të qytetarëve në mënyrë institucionale, ngase po këta qytetarë tashmë të pastruar në trurin e tyre që vetëm konstaton parregullsi, po u shkojnë mbrapa oligarkëve financiarë, të cilët përpos interesave postare dhe materiale nuk njohin asgjë tjetër.

Në këtë shtet ndodhi diçka e çuditshme dhe tejet kontradiktore në lidhje me luftimin e krimit ekonomik. Policia para do kohesh në kufirin e Tabanocit dhe të Qafë Thanës arrestoi ca policë për ryshfet dhe korrupsion, kurse pastaj policia arrestoi një biznesmen të Malit të Zi për larje të parave, ndërkaq të dy palët do gjykohen nga njerëzit e infektuar që moti me këtë virus. Kësisoj, në vendet me nivel të lartë të pisllekut është vështirë apo e pamundur parandalimi dhe luftimi i pastrimit të parave të pista, sepse pislleku e tërheq mikrobin, kurse mikrobi është i rehabilituar dhe i kënaqur në pisllek<sup>392</sup>.

### Sfidat e parandalimit dhe luftimit të pastrimit të parave

Nuk është thënë kot se sëmundja më mirë është të parandalohet, se sa të mjekohet. Një parandalim ose në rast të dështimit të kësaj të parës një luftim me të gjitha mekanizmat shtetërorë të ligjshëm kundër larjeve të parave është tejet e vështirë. Këtë proces,

<sup>392</sup> Iljasa Salihu, "Rrugëtimi nëpër mjegulla", Shkup, 2010, f. 99.

përpos ndërlikueshmërisë së vetë dukurisë, të vështirë e bën edhe piramida e cila merret me parandalimin apo me luftimin e kësaj dukurie famëkeqe. Për parandalimin dhe luftimin e parave janë themeluar dhe funksionojnë shumë agjenci dhe drejtori që merren me evitimin e kësaj dukurie. Madje përmes ligjit shtetëror, pavarësisht fazës e zhvillimit të shtetit, kjo vepër konsiderohet penale, ku metodat për gjurmimin e atyre që merren me larje parash përdoren në përputhje me ligjet kushtetuese, pastaj dënimi, konfiskimi i pasurive të grumbulluara përmes kësaj metode kryhen dhe rregullohet përmes ligjit, pra ndjekja e kësaj vepre penale bëhet përmes akteve ligjore, gjë që i jep të drejtë edhe kryerësve që në vazhden e kësaj veprimtarie lirshëm mund ta quajnë veten kriminel, si dhe patjetër u nevojitet të qëndrojnë ndërmjet tendave në pyll dhe hoteleve luksoze nëpër metropolet botërore. Kësisoj për herë të parë në legjislacionin penal të Republikës së Shqipërisë problemi i pastrimit të parave të pista u rregullua në formë të kënaqshme në vitin 2000 me nxjerrjen e ligjit nr. 8610, datë 17.05.2000, i cili në nenin 2 të tij nënvizonte: “... *Pastrimi i parave është qarkullimi dhe riqarkullimi i parave të rrjedhura nga veprimtaria kriminale, më poshtë të quajtura “të papastra” ...*”<sup>393</sup>.

Edhe përkundër sanksioneve të ndryshme që parashihen nëpër legjislacionet e ndryshme shtetërore, prapë kjo vepër penale vazhdon të lëshojë shtat edhe nëpër skutat, ku shpeshherë edhe këmba e njeriut frikohet të shkelë. Njëra prej shumë sfidave në këtë rrugëtim institucional dhe shtetëror është edhe çështja e shndërrimit të produkteve të ndyta në produkte të pastra. Veçmas ky shndërrim ka tendencë të pranohet prej qytetarëve të cilët janë të uritur për të mira materiale dhe si të tillë me kënaqësinë më të madhe të mundshme e përqafojnë një produkt të caktuar, pavarësisht prejardhjes dhe rrugëtimet e atij produkti, për këtë kategori njerëzish mjafton që produkti në fjalë po i sjell mirëqenie ekonomike.

<sup>393</sup> Ligji “Për parandalimin e pastrimit të parave”, nr. 8610, datë 17. 05. 2000, faqe 1, Tiranë, Gazeta zyrtare, korrik 2000; ndryshuar me ligjin nr. 9917, datë 19.15.2008.

Sfida tjetër është çështja e medimeve përmes të cilëve me shumë efektivitet mund të parandalohen dukuri të tilla devijuese. Po qe se kalimthi i hedhim një vështrim, e kam fjalën vështrim prej prizmit shoqëror, jo institucional, shumë lehtë mund të vijmë në konstatimin se pas këtij mediumi qëndron një njeri shumë i pasur, me burim të padeklaruar të të ardhurave, mbase përmes aktiviteteve të tij kriminale, “bosi” në fjalë në kuadër të transformimit të mjeteve ilegale në legale, ka bërë hapjen e mediumit në fjalë, arsyeja e pash-pallur asnjëherë është pastrimi i parave përmes mediumit, i cili ka gjasa që t’i shërbejë në të ardhmen si mburojë e veprave të mëtutjeshme kriminale, ngase siç dihet, sot roli i medimeve është tejet ndikues, mbase jo rastësisht për mediumet në përgjithësi thuhet se i përkasin pushtetit të katërt. Mjafton që prej gazetarëve të ngrihet pluhur i madh për ndonjë paralajmërim për ndjekje penale për “bosin” e tyre, gazetar që pas mbarimit të fakultetit kishin mbetur të papunë, ndonëse në sfondin e kësaj amullie, ata që janë të interesuar ta bëjnë larjen e parave përmes themelimit të medimeve dhe e njëjta t’i shërbejë si mburojë për veprat kriminale që do të kryhen në të ardhmen, këta gazetarë të njomë dhe të uritur (kuptohet edhe në këtë rast kemi përjashtime) nuk do të pyesin për prejardhjen e këtij “produkti gjigant”, por do të ngazëlleshin se gjeten folenë ku do të mund të kultivojnë dhe zhvillojnë profesionin e tyre.

Por sfida tjetër ndërlihet me investimet e shtetit apo komunës në ndonjë projekt të caktuar. Përmes këtij procesi investues oligarkia e pushtetit shumë lehtë dhe pa zhurmë do të ketë mundësi që parat e vjedhura që më parë ishin dedikuar për objekte të ngjashme, tashmë përmes investimit publik të paplanifikuar më parë, madje duke mos pasur as bazë për investim publik prej buxhetit të shtetit, oligarkia politike dhe ekonomike do të jetë e prirë që përmes legalizimit të një pjesë të parave të vjedhura prej fondeve dhe qytetarëve, formalisht të investojë diku që shihet prej qytetarëve, duke tentuar që në sytë dhe në gojët e qytetarëve të hedhin rërë, në mënyrë që ata të mos kenë mundësi të pyesin për ato para, fonde apo donacione që janë avulluar,

mbase edhe pas këtij procesi avullues mungoi në kopshtet e qytetarëve shiu, proces që i përket natyrshmërisë së këtij planeti.

### Falsifikimi i parave

Paraja përpos që pastrohet, ajo është dëshmuar se edhe falsifikohet. Si te njëra ashtu edhe te tjetra, viktimë është qytetari, përkundrajsisht se format e viktimizimit dallojnë, por jo edhe thelbi. Paraja si para drejtpërdrejt nuk plotëson kurrfarë nevojë njerëzore dhe se nuk pranohet për atë se ka ndonjë nevojë vlerë. Por vlera e saj bazohet në funksionimin e mjetit të këmbimit dhe në mundësinë që me ato para të këmbehen me mallra të tjerë, d.m.th. mundëson blerjen e mallrave të ndryshme në treg<sup>394</sup>. Madje disa teoricienë kanë shkruar edhe më tej në lidhje me vlerën e parasë në vete, duke e paraqitur vetëm një copëz metalike ose një fletëz ku përbërja e saj vlen aq sa vlen edhe një letër e bardhë që shërben për ndezjen e zjarrit. Por me paraqitjen e shumëllojshmërisë së mallrave në vlerë dhe në sasi, doli sheshit se është e patjetërsueshme ndërmjetësimi i ndonjë sendi që të mund të matë dhe vlerësojë vlerën e mallrave. Kështu pas një evoluimi disa shekullor sot parandehet mund ta komentojmë si pranim i reflektimit të vlerës së ndonjë malli të caktuar. Për këtë arsye sot rolin e emetimit në vendet e Eurozonës (lëshimit të diçkaje në përdorim, prodhim) e ka marrë Banka Qendrore Evropiane (ECB) (European Central Bank) e cila është një nga bankat qendrore më të rëndësishme në botë, përgjegjëse për politikën monetare për vendet anëtare të Eurozonës, Qendra e saj gjendet në Frankfurt, Gjermani. Pavarësisht se shtetet janë anëtare të eurozonës apo nuk janë, secili shtet i pranuar ndërkombëtarisht e ka të drejtën ligjore, përpos detyrave të tjera, të bënë emetimin e kartëmonedhave apo monedhave kombëtare, me përjashtim të atyre shteteve që i përkasin eurozonës.

Përkundrajsisht gjithë këtyre filtrave, kontrollimit, vëzhgimit dhe përgjegjësisë të panumërta që kanë të bëjnë me emetimin dhe

<sup>394</sup> Sabahudin Komoni, "Financat", Prishtinë, 1986, f. 23.

mbikëqyrjen e parasë si pranuese e reflektimit të vlerës së mallrave, prapë pranë këtij organi të ligjshëm dhe profesional qëndron xhungla e cila “me sukses” ndjek hapat e asaj që kanë të bëjnë me kopjen dhe falsifikimin e këtyre mjeteve të ligjshme.

Nëse e ndjekim dhe e kuptojmë mirë çështjen e pastrimit të parave, atëherë nuk do ta kemi vështirë ta hedhim një paralele ndërmjet pastrimit të parave dhe falsifikimit të parave. Nëse me pastrimin e parave të pista nënkuptojmë ligjësimin e mjeteve monetare dhe të pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme, atëherë me falsifikim të parave përgjithësisht nënkuptojmë monedhën që është prodhuar pa sanksion dhe urdhër ligjor të shtetit, duke pasur për qëllim ngjasimin me monedhat zyrtare të shtetit apo të paktën të jetë e afërt me monedhat zyrtare, nëpërmjet së cilës lehtas të mund të mashtrohen konsumatorët. Edhe falsifikimi i parave paraqet mugullimin e së ligjshmes përmes së paligjshmes. Aktorët të cilët merren me këtë veprimtari s’do mend se i përkasin familjes së piramidave të krimit. Madje të njëjtët aktorë me role të ndryshme mund të paraqiten në skenën e larjeve të parave, në zhvillimin e dukurisë së korrupsionit, në komplotet e ndryshme që si qëllim kanë tentimin e pastrimit të fëlliqësirave të veta e të ngjashme.

Rreziku i kësaj dukurie mjaft të përhapur në vendet në transformim qëndron në atë se, përmes letrave pa kurrfarë vlere tentohet që me shumicë të “grabiten” mallrat e kushtueshme, duke bërë kështu një çrregullim të hatashëm në treg, ngase si rrjedhojë e kërkesës së madhe në treg për mallra të ndryshëm që mund ta pllakosë edhe ofertën në dorëzim, ka gjasa reale që dukshëm të rriten çmimet e mallrave, madje edhe të mallrave të domosdoshme për përditshmërinë e shoqërisë. Pasi që lloji i këtyre kriminelëve ta shohin se në tregun shtetëror e arritën atë që e kishin synuar, do t’i sjellin në të njëjtin treg të njëjtat produkte (qoftë edhe me afat të kaluar) për dallim prej herës së parë, tanimë çmimi ka gjasa të jetë më i lartë, duke realizuar kështu fitim marramendës dhe të dyfishtë prej transaksioneve kriminale. Përmes kësaj metode kriminale, do të kemi në treg mungesë të mallrave, rritje të çmimeve dhe çrregullim

të parave të ligjshme, madje edhe Banka Kombëtare do ta sheh veten në gjendje tejet të palakmueshme, sepse në raste të këtilla do të paraqitet një hendek shumë i madh ndërmjet mjeteve të emetuara dhe produkteve vendore dhe të sjella prej jashtë. Bruto Prodhimi Vendor (Bruto produkti vendor – BPV, Gross domestic product, GDP), i cili është një indikator ekonomik që paraqet vlerën nominale të të gjitha të mirave materiale dhe shërbimeve të prodhuara brenda një periudhe (zakonisht një viti) të një ekonomie të një shteti, pranë dukurisë së falsifikimit të parave ka gjasa të mëdha që treguesit të cilët e matin BPV-në, t’iu nënshtrohen shifrave të fryra apo të zymta, duke munguar një saktësi e vërtetë e BPV-së, mbase është i njohur roli vital në shtetet kombëtare i këtij treguesi, ku nëpërmjet BPV-së mund të shihet ecja përpara e ekonomisë shtetërore, apo ngecja e ekonomisë në fjalë, pse jo edhe gjasat për zhvillim në të ardhmen<sup>395</sup>.

Kështu që, mjetet e fituara përmes falsifikimit të parave, njësoj sikurse pastrimi i parave të pista, në mendësinë e llojit të këtyre kriminelëve qëndron botëkuptimi kryeneç se patjetër duhet t’i nënshtrohen këto para procesit të ligjësimit, ndonëse kriminel, por në periudha afatgjate edhe ato i frikohen kapjeve dhe dënimeve eventuale të kobshme, ndaj prirja e tyre është që sa po të dalin në “kapërcyellin e shpëtimit” të fillojnë të hapin ndërmarrje të mëdha me punëtorë të ndershëm, ku kriminelin i djeshëm i cili kishte përhapur rrëmujë dhe kaos ndër popull, tashmë po i njëjti me kravatë, këmishë të bardhë, duke buzëqeshur paqësisht herë pas here, do të menaxhojë gjoja ndershëm me këta punëtorë dhe me tregjet e tjera të caktuara, përkundër faktit se mbi supet e tij qëndrojnë me dhjetëra apo me mijëra viktima.

---

<sup>395</sup> Iljasa Salihu “Krimi ekonomik – sfidat e sigurisë kombëtare në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, përballë krimit ekonomik”, Shkup – 2012, f. 125.

## Përfundim

Larja e parave të pisa është veprimtari shumë e keqe për shumë arsye, por për një arsye të veçantë është lebetitëse; përmes kësaj rruge kriminale, lehtas krimineli në sytë e njeriut, shoqërisë dhe të shtetit trajtësohet në njeri i mirë dhe i besueshëm për ta ngarkuar me ndonjë përgjegjësi të madhe. Larjes së parave i prinë larja e mendjeve. Vetëm mendjet që në kujtesën e tyre kanë arritur t'i pastrojnë gjërat që nuk duhet të pastrohen, kanë mundësi t'ia rrahin supet kriminelëve në shenjë ledhatimi. Larja e parave dhe falsifikimi i parave kanë për qëllim kryesor fshehjen dhe asgjësimin e gjurmëve të kriminit, ngjashëm siç rëndom veprojnë kriminelët. Këtyre i duhet vetëm tollovitja e burimit financiar në njërën anë dhe krijimi i një burimi të rrejshëm në anën tjetër. Këta nuk duan të pyeten se si erdhën deri te milionëshi i parë, përndryshe pas kësaj etape janë në gjendje t'i shlyejnë detyrimet financiare në të gjitha faturat. Logjika e tyre ka në spikamë varfërimin e popullit për një kohë, që pastaj po këta grykor të kthehen si shpëtimtar të popullit. Këta e duan një popull të varfër përgjatë fazës së pasurimit të tyre, sepse vetëm një popull i këtillë nuk mund ta ketë dertin të burimi financiar, por të sigurimi i një kafshate goje, gjë të cilën këta janë në gjendje t'ia sigurojnë, madje t'ia dhurojnë edhe një buzëqeshje. Lloji i këtyre kriminelëve kanë lidhje të ngushta me politikën dhe me pushtetin, madje vetë këta janë politika dhe pushteti. Shpëtimi prej këtyre vargonjve fillimisht gjendet në propozimin dhe miratimin e ligjit për konfiskim të pasurisë së paligjshme, në ngritjen e vetëdijes për një krim të tillë, që duhet ta bëjnë institutet, shoqatat dhe intelektualët dhe pastaj në vigjilencën përpara kutisë së votimit.

Literatura e shfrytëzuar:

1. Iljasa Salihu “*Krimi ekonomik – sfidat e sigurisë kombëtare në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, përballë krimit ekonomik*” - Shkup
2. Sabahudin Komoni, “*Financat*” - Prishtinë
3. Luan Gjonca, “*Korrupsion*” - Tiranë
4. Iljasa Salihu, “*Rrugëtimi nëpër mjegullë*” - Shkup
5. Revista shkencore “*JUSTINIANI I*” Nr.1 - Tiranë
6. Portali “*www.lajmpress.com*”
7. Portali “*www.time.ikub.al*”
8. Portali “*www.evropaelire.org*”